

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISE CIVILE NDAJ TË TRETEVE, NGA AKTIVITETI.

Neni 1. "PËRCAKTIME"

Kushtet e përgjithshme të kontratës së sigurimit për përgjegjësinë civile të ardhur nga ushtrimi i aktivitetit, këtu e në vazhdim do të quhen "Kushtet e Sigurimit". **Dëshmia e sigurimit**, që vërteton lidhjen e kontratës së sigurimit, këtu e në vazhdim do të quhet "Polica e Sigurimit". **ALBSIG SHA** është Siguruesi i kësaj kontrate sigurimi. **Policmbajtësi ose "Kontraktuesi"** do të kuptohet personi që kryen veprime dhe nënshkruan kontratën e sigurimit për llogari dhe në emër të të Siguruarit/ve. I **Siguruari** është personi fizik ose juridik interesi pasuror i të cilit mbulohet me sigurim sipas ketyre kushteve sigurimi. I siguruari dhe Policmbajtësi janë i njejtë person, përveç rasteve të nënshkrimit të polices për llogari të të tjerëve. **Shtese e personave të siguruar**, me kusht që të jete kërkuar dhe të specifikohet në formularin e sigurimit termi i Siguruar do të zgjerohet dhe të përfshijë personat si me poshtë: **a)** Perfaqësuesit ligjore të të Siguruarit, personat që drejtojnë aktivitetin e të Siguruarit ose pjesë të tij, përsa kohë ata janë duke kryer detyrat e tyre funksionale; **b)** Të gjithë punëmarresit e të Siguruarit përsa kohë ata janë duke kryer detyrat e tyre funksionale bazuar në një kontratë pune me afat, kontratë shërbimi a prove, për llogari të aktivitetit të të Siguruarit; **c)** Të gjithë personat e punësuar nga i Siguruari që kryejnë aktivitetin e tyre profesional në shërbim dhe në ndihmë të aktivitetit të siguruar, si punonjësit e menses/ve, pastrimit, etj. shërbime të kësaj natyre.

A.PER TË GJITHE LLOJET E RREZIQEVE (Aktiviteteve të Siguruar)

Neni 2. "OBJEKTI I KONTRATËS, RREZIQET E SIGURUARA"

Objekti i kësaj kontrate është marrëdhënia juridike në të cilën Siguruesi, brenda limitit të dëmshpërblimit dhe në përputhje me këto kushte sigurimi, në zbatim të vendimit të gjykatës për ngarkimin me përgjegjësi ligjore të të Siguruarit e kompenson atë, përkundërt pagimit të primit të sigurimit prej tij, për: **2.1** Dëmshpërblimin e humbjeve dhe dëmeve të palëve të treta duke përfshirë edhe shpenzimet dhe kostot ligjore të të Siguruarit për mbrojtjen e interesave të tij gjatë procesit të gjykimit, të shkaktuara nga ngjarje të papritura, të pa parashikuara (aksidente) të ndodhura në ambientet ku ushtrohet aktiviteti i të Siguruarit që rezultojnë me pasoja në: **a)** Shëndetin e palëve të treta, që nënkupton dëmtime fizike, sëmundjen ose vdekjen e çdo personi që nuk është palë në këtë kontratë sigurimi (dëme në njëzëri). **b)** Sendeve të palëve të treta, që nënkupton dëmtime fizike ose shkatërrim të pronës në zotërim të çdo personi ose enti që nuk është palë në këtë kontratë (dëme në sende); **2.2** Palet e treta sipas përshkrimit në paragrafin (1) me siper nuk përfshijnë punonjësit e të Siguruarit, nëse nuk është rënë dakord ndryshe me shkrim; **2.3** Nëse miratohet vecanerisht me shkrim në kontratën e sigurimit (police), ky sigurim mbulon gjithashtu përgjegjësinë për humbje që rezultojnë prej burimeve të rreziqeve që kërkojnë një prim të vecantë

ose prim shtese, shih burimet e rreziqeve individuale me poshte pika B).

Neni 3. "BURIMET E RREZIQEVË TE SIGURUARA"

3.1 Burimet e Rreziqeve te mbuluara me sigurim lidhur me pergjegjesine civile te te Siguruarit nga ushtrimi i aktivitetit jane ato te shkaktuar nga: **a.** perdorimi, zoterimi, zoterimi me kontrate leasing ose usufrukti i Tokes, Nderteses, Dhomave te Veçanta te perdorura ekskluzivisht per ushtrimin e aktivitetit; **b.** perdorimi ose zoterimi me qira i ambjenteve me funksion social ne ndihmese ekskluzive te punonjesve te aktivitetit te siguruar, si mensa, pishina, vende pushimi dhe ambjente te ngjashme, si edhe sheshe lojrash; **c.** perdorimi i ashensore per persona dhe mallra; **d.** perdorimi i makinave vete-levizese te punes ne gjendje stacionimi ne sherbim te aktivitetit, pra qe nuk levizin; **e.** magazinimi i lendeve te djegshme dhe karburanteve; **f.** humbja ose vjedhja e sendeve personale te punemarresve te te Siguruarit, duke perjashtuar parate, sendet me vlere, sahatet e dores, pajisje teknike dhe elektronike si kamera, video-kamera, Lap Top (portable computer) dhe pajisje te tjera ngjashme, kambiale e letra me vlere, dokumente te çdo lloji, me kusht qe sendet personale te punemarresve te jene te ruajtura ne dhoma te mbyllura me çeles. **3.2** Burimi i Rrezikut te mbuluara me sigurim i Drejtuesve (menaxhereve) te aktivitetit, te Perfaqsesve ligjore dhe te Punemarresve te tjere te te Siguruarit perfshijne pergjegjesine e tyre ligjore perderisa ato jane ne ushtrim te detyrave te tyre funksionale e profesionale lidhur me aktivitetin e te Siguruarit.

Neni 4. "PËRJASHTIME NGA MBULIMI"

4.1 Siguruesi nuk mbulon dhe demshperblen humbje dhe demtime qe vijne nga

aksidente te shkaktuara qellimisht nga i Siguruarit. Termi qellimisht perfshin: **4.1.1.** Veprime dhe mosveprime te te Siguruarit, megjithse pasojat e rrezikshme nga veprime dhe mosveprime te tilla duheshin pritur ose parashikuar; **4.1.2.** Dhunim i qellimshem prej te Siguruarit i rregullave e rregulloreve ne fuqi; **4.2.** Kerkesat per demshperblime si me poshte, jane te perjashtuara nga mbulimi: **4.2.1** Pergjegjesi lidhur me deme shendetesore te çdo personi qe punon per llogari te te Siguruarit me kontrate punesimi, marrje ne prove, kontrate nenkontraktimi apo tjetër; **4.2.2 -a** deme te vete te Siguruarit dhe ortakeve te tij, nese pjesa ose zoterimi i tyre ne kompanine e siguruar kalon 25% dhe ato kane te drejte ose mundesi te drejtojne kompanine ne baze te ligjit ose statutit (Ortakët ne maxhorance); **-b** deme te anetareve te familjes te te Siguruarit, bile edhe nese jane te punesuar prej tij, si edhe anetareve te familjeve te Ortakeve ne maxhorance, qe jane punesuar ne kompani pergjegjesia e te ciles eshte e siguruar. Familjare konsiderohet bashkeshorti, bashkejetuesi, perfaqsesi ligjor dhe personat qe mbahen financiarisht nga i Siguruarit ne kohen e ndodhjes se ngjarjes se sigurimit. **4.2.3** Pergjegjesi te ardhura prej çdo shkaku ose ngjarje aksidentale ne sende (deme materiale), qe i perkasin te Siguruarit, ose jane nen kujdesin, ruajtjen apo kontrollin e tij, ose te çdo personi qe punon per llogari te tij; **4.2.4** Për demtime dhe humbje ne persona dhe sende te shkaktuara nga çdo lloj produkti e sherbimi qe i Siguruarit ka nxjerre ne treg. **4.2.5** Për demtime dhe perkeqesim te shendetit te personave qe shkaktohen nga procedura trajtimi mjekesor dhe operacione te tjera mbi keto persona te tilla si, trajtime obstetrike, trajtime kozmetike ose kujdesi trupor; **4.2.6** Demtim dhe perkeqesim i shendetit te kafsheve shtepiake qe

rezultojne nga trajtime mjekesore e operacione te tjera te kryera mbi keto kafshe si kastrimi, pjellshmeria, mbathja e patkojve, trainimi; **4.2.7** Të shkaktuara nga veprime direkte ose indirekte te te Siguruarit me pasoje ndotje ambientale ose ekologjike të tokes, ujit, ajrit; **4.2.8** Pergjegjesi per deme ne sende te shkaktuara nga ndikimim i temperatures, gazit, avullit, lageshtise, rreshjeve, blozes, pluhreve, dridhjes, zhurmave e fenomenve te ngjashme qe vijne nga demtime graduale ose ndikimi i tyre per nje kohe te gjate mbi sendin e demtuar; **4.2.9** Deme te personave (shendetesore) e sendeve te shkaktuara nga rrezatimi ose ndotja jonizuese nga radioaktiviteti prej karburanteve berthamore, rrjedhjeve berthamore; **4.2.10** Deme te shkaktuara paleve te treta te mbuluara nga sigurimi i detyrueshem sipas legjislacionit ne fuqi per pronaret e perdoruesit e mjeteve te transporti Tokesor, Ajror dhe Ujor, qe qarkullojne ne territorin e Republikes se Shqiperise; **4.2.11** Deme te shkaktuara per shkak se i Siguruari nuk parandaloi veprimin e rrethanave te rrezikshme, sipas kerkeses së Siguruesit. Ne rast dyshimi, rrethana te rrezikshme do te konsiderohen ato rrethana per shkak te te cilave ka ndodhur demi; **4.2.12** Deme te shkaktuara si pasoje e perdorimit te droges e substancave te tjera te ndaluara narkotike e psikotrope; **4.2.13** Demtime shendetesore per shkak te semundjeve profesionale, asbestit, ndryshimeve gjenetike ne organizem, radiacionit radiokativ, duhanit. Demet trupore per shkak perdredhje, ndrydhje apo dalje nga vendi te kockave cervikale, te toraksit dhe te mesit, pervec rastit kur demtimi i kolones vertebrale ose levizja ndermjet vertebrave tejkalon 3 mm, fakt qe vertetohet nga analizat mjekesore; **4.2.14** Per pergjegjesi kontraktore te marra persiper nga i Siguruari, pervec rastit kur nje

pergjegjesi e tille do ti ngarkohej te Siguruarit edhe ne mungese te kesaj kontrate; **4.2.15** Deme si pasoje e luftes, nderhyrjes se forcave te huaja ushtarake pavaresisht se lufta eshte shpallur ose jo, lufta civile, revolucioni, aktet terroriste, aktet e sabotozhit dhe aktet e vandalizmit; **4.2.16** Per shkak te gjobave, denimeve te te gjitha llojeve qe nuk kane qellim kompensimi, por jane thjesht deme ndeshkimore; **4.3** Po te mos jete rene dakord shprehimisht me shkrim, Siguruesi nuk mbulon pergjegjesi per: **4.3.1** Deme per shkak te pjesmarrjes aktive ne gara me makina, motorçikleta, biçikleta, gara me kuaj, sporte luftarake si dhe pergatitjet (trajnimi) per keto gara; **4.3.2** Deme ne sende te cilat i Siguruari i zoteron ne çfaredo menyre (nepermjet nje kontrate qiraje (leasing), per ruajtje magazinim, etj.); **4.3.3** Deme ne Mjetet motorrike nen kujdesin e te Siguruarit. **4.3.4** Deme ne sende, artikuj te tjere te cilat jane objekt i trajtimit, procesimit, proves etj. nga i Siguruari; **4.3.5** Deme per shkak te demtimeve te sendeve te te Tjereve, shkaktuar pergjate procesit te ngarkim-shkarkimit me mjete dhe pajisje ngarkim shkarkimi; **4.3.6** Kerkesa rekursi (rimbursimi) nga Institute Sigurimi dhe Kompani Sigurimi te Shendetit, Pensionit dhe Pa Aftesie qe lidhen me sigurime shendeti, si dhe kerkesa te tilla nga te tjere kerkues indirekt.

B. BURIME INDIVIDUALE SHTESE TE RREZIKUT (Aktivitetit te Siguruar)

Neni 5. "BURIME INDIVIDUALE RREZIKU (PER AKTIVITETIN E SIGURUAR)"

5.1 Cilado qofte natyra ose lloji i Aktivitetit te siguruar, ky sigurim zgjerohet te mbuloje pergjegjesine e te Siguruarit i cili shfrytëzon per nevoja te ushtrimit te aktivitetit te siguruar nje linje hekurudhore industriale (ne fushe, pyll dhe lidhjet e nevojshme),

teleferik, etj. te kesaj natyre, ku transporti i lendeve te para dhe mallrave kryhet pa pagese; **5.2 Biznesi i Ndertim-Montimit** ne shtese te pergjegjesise se pergjithshme te tij eshte i mbuluar edhe per pergjegjesine pergjate kryerjes se aktiviteteve te meposhtme si, punime shpimi, prishje per nevoja ndertimi te ri dhe rindertimi, perdorimi i skelave te ndertim-montimit, perdorimi i maqinerive te ndertimit, punimet me llaç dhe suvatime, prodhimi i produkteve te betonit, perpunimi i gureve artificiale, germime ne rere dhe zhavore, germime ne kavo per prodhim guri, punime armature, punime muri dhe te ngjashme; **5.2.1 Pergjegjesia per deme ne pajisje e instalime nentokesore te (gazit, ujit, linjave elektrike), kanale, themele e objekte te ngjashme, mbulohet vetem nese:** **5.2.1.1 Pergjegjesia per deme ne pajisje e instalime nentokesore te (gazit, ujit, linjave elektrike), kanale, themele e objekte te ngjashme, mbulohet vetem nese:** **a)** vlere e demit kalon shumen prej Lek 50,000 ose kundervleften e saj ne monedhe tjeter, **b)** pergjegjesia per deme ne objektet mbi te cilat i Siguruari punon, trajton ose kujdeset te mos jete perjashtuar, ne pajtim me parashikimet e nenit 4, paragrafi 3, pika 4 e ketyre kushteve te pergjithshme. **5.2.1.2 Ky sigurim mbulon edhe pergjegjesine per shperthime, por demet ne sende perjashtohen nese:** **a)** natyra e punimeve perfshin deme ne sende pavaresisht plotesimit te rregullave te sigurimit teknik (pra kryhet pune mbi objekte me karakteristika vecanerisht te rrezikshme), dhe **b)** sendet ndodhen me pak se 75 m larg nga pika ose vendi i shperthimit, po te mos jete rene dakord ndryshe; **5.2.1.3 Pergjegjesia per deme perjashtohet nga mbulimi per rastet si me poshte:** **a)** Ne ndertesat ose pasurite e luajtshtme te cilat i Siguruari duhet te realizoje ose ndertoje vete; **b)** Ne ndertesat ose pasurite e

luajtshtme mbi te cilat i Siguruari punon, po te mos jene marre ne sigurim vecanerisht ne perputhje me nenin 4, paragrafi 3, pika 4, e kushteve te pergjithshme; **c)** Per shkak te kerkesave per demshperblim qe vijne nga ndertesat fqinje ne ndertim, qe rezultojne ose te shkaktuara nga mungesa e masave te pershtatshme mbrojtese si perforcimet, mbarteset, mbeshteteset; **d)** Deme qe vijne nga qe i Siguruari ose i besuari i tij i ngarkuar me mbikqyrjen e punimeve shkaktojne deme duke shkelur ne menyre te vullnetshme rregullat teknike ose rregulloret ne fuqi te vendosura nga Autoriteti teknik kompetent; **e)** Deme qe ndodhin pergjate periudhes se garancise dhe/ose mbas dorezimit te punimeve tek autoriteti kontraktues (perfituesi). **5.3 Familja Fermere,** mbulohet per pergjegjsine e zoterimit dhe shfrytezimit per nevoja te vete fermes te bagetive, qe perfshin edhe pergjegjesine e bariut ose personave te tjere qe kujdesen per rritjen e ruajtjen e bagetise. Gjithashtu mbulohet edhe pergjegjesia nga aktiviteti i prerjes se drureve per nevojat e veta ne pyllin e vete fermes. **5.4 Ky sigurim mbulon Pergjegjesine e Kryefamiljarit dhe Anetareve te familjes se tij per shkak te Zoterimit te Baneses e Tokes (truallit), pershkruar si burim rreziku ne Nenin 3, paragrafi 1, Pika 1 dhe 2; 5.4.1 Nese nje ndertese ka disa pronare pjeset ideale te te cileve nuk kalojne 30% te vleres totale te saj, Siguruesi mbulon, nese nuk parashikohet ndryshe, kerkesat per deme te nje bashkepronari ose anetareve te familjes se tij qe jetojne me te ne te njejten banese per shkak te perdorimit te pjeseve te perbashketa te nderteses, perkundrejt bashkepronareve te tjere, por vetem ne raport me pjeset ideale te bashkepronareve te tjere ne keto dhoma (ambiente) te perbashketa; **5.5 Siguresi mbulon te Siguruarit qe ushtrojne aktivitet Hotelerie, Shtepive-Hotel** (qe nenkupton**

dhenien e nje pjese te shtepise me Qira “bed & board” ku vete pronaret (te Siguruarit) jetojne ne pjesen tjeter te shtepise), **Restorante, Shtepi Pushimi** dhe te ngjashme per pergjegjesite qe vijne nga zoterimi e perdorimi: **a)** i ambjenteve ndihmese qe i perkasin te Siguruarit per perdorim vetem per nevojat e veta si, lavanderi, furre buke, mishtore dhe ambjente ndihmese te ngjashme, **b)** si edhe te zoterimit te pajisjeve e veglave sportive per ushtrimin e aktivitetit sportiv per kenaqesine e mysafireve; **5.5.1** Gjithashtu mbulohet edhe pergjegjesia e te Siguruarit nga kerkesa per zhdukjen apo vjedhjen e sendeve te ndodhura ekskluzivisht ne dhomat e dhena me qira qe i perkasin mysafireve te akomoduar apo familjareve te tyre, pervec mjeteve motorrike te cdo lloji, pjeseve te tyre dhe sendeve te ndodhura ne keto mjete. Zhdukja ose vjedhja e parave, sendeve me vlere, sahatet e dores, pajisje teknike dhe elektronike si kamera, video-kamera, Lap Top (portable computer) dhe pajisje te tjera ngjashme, kambiale e letra me vlere, dokumente te cdo lloji qe i perkasin mysafireve te akomoduar apo familjareve te tyre, mbulohen nga Siguruesi me kusht qe keto sende te jene depozituar tek i Siguruari dhe ai/ajo (mysafiri) i ruan ato ne nje vend te mbyllur me celes; **5.5.2 Siguruesi nuk mbulon kerkesa per zhdukjen ose vjedhjen e sendeve qe i perkasin mysafireve ne dhomat ose ambjentet e perbashketa** te Hotelit, Shtepise-Hotel, Restorantit, Shtepise se Pushimit dhe Aktiviteteve te ngjashme, pervecse kur ato depozitohen; **5.5.3** Nese sendet humbin apo zhduken i Siguruari duhet te njoftoje menjehere Autoritetin kopetent (Policine e Shtetit). **5.6** Siguruesi Mbulon pergjegjesine e te Siguruarit qe ushtron aktivitet Spitalor, Klinika, Sanatoriume dhe te Ngjashme, per humbje te sendeve qe i perkasin pacienteve,

shoqeruesve te tyre dhe vizitoreve. Parate, sendet me vlere, sahatet e dores, pajisje teknike dhe elektronike si kamera, video-kamera, Lap Top (portable computer) dhe pajisje te tjera ngjashme, kambiale e letra me vlere, dokumente te cdo lloji, **mbulohen me kusht qe keto sende te jene depozituar tek i Siguruari dhe ai/ajo ti ruaje ne vende te mbyllura me celes.** Nese sendet humbin apo zhduken i Siguruari duhet te njoftoje menjehere Autoritetin kopetent (Policine e Shtetit). **5.6.1 Ky sigurim nuk mbulon pergjegjesine e te Siguruarit** nga kerkesa per deme te personave qe punojne per llogari te te Siguruarit, per qellime shkencore ne verifikimin e vleresimin e efekteve te pajisjeve dhe procedurave te vecanta mjekesore. **5.7** Ky sigurim mbulon pergjegjesine e **Shoqatave / Enteve te Siguruara** per shkak te zoterimit, ose perdorimit te ndertesave te marra me qira, trojeve, dhomave dhe pajisjeve me qellim ushtrimin e aktivitetit per te cilin ato jane ligjeruar (licensuar) te tilla si vende trajnimi, vende lojrash e argetimesh te ndryshme, poligone sportive dhe ambjente te ngjashme, per deme te shkaktuara ne aktivitete te zakonshme ne perputhje me statutin e ketyre shoqatave si, mbledhja e pergjithshme e anetareve, mbledhe ceremoniale etj. te kesaj natyre; **5.7.1** Mbulohet gjithashtu aktiviteti zyrtar i personave te autorizuar te perfaqesojne shoqaten, si edhe pergjegjesine personale te anetareve te nje shoqate per shkak te aktivitetit te tyre ne eventet e organizuara nga shoqata. **Megjithate nuk mbulohet pergjegjesia personale per shkak te aktiviteteve jo ne interes te shoqates ne te cilen ato bejne pjese;** **5.7.2** Qe rezulton nga zoterimi ose perdorimi i bicikletes; **5.7.3** Per Brigadat ose Repartet Zjarrfikse ky sigurim mbulon pergjegjesine e tyre per deme te shkaktuara ne punimet shpuese pergjate

shpetimit dhe dhenies se ndihmes, por nuk mbulon deme ne sende, per mbrojtjen ose shpetimin e te cilave ato (Zjarrfikesit) jane thirrur; **5.7.4** Nese kerkohet dhe jepet mbulimi nga Siguruesi vecanerisht, ky mbulim zgjerohet te mbuloje pergjegjesine e shkaktuar nga: **a)** aktivitete qe kalojne kornizen ose gamen e aktiviteteve te zakonshme te nje shoqate, te tilla si ekspozitat, ceremoni te nivelit qeveritar ose shteteror dhe te ngjashme; **b)** zoterimi i kafsheve; **c)** zoterimi i ndertesave e trojeve qe nuk perfshihen drejtperdrejt ne aktivitetin e nje shoqate; **d)** zoterimi dhe pronesia e cdo kompanie (subjekti tjetër), si bare, restorante e te ngjashme. **5.8** Ky sigurim mbulon pergjegjesine e te **Siguruarit si Person Privat**, per shkak te: **5.8.1** Rreziqeve te jetes se perditshme, por jo per shkak te rreziqeve qe lidhen me profesionin si edhe ushtrimin e aktiviteteve vecanerisht te rrezikshme; **5.8.2** Si kryetar familje (zot shtepie), si punedhenes i punonjesve te sherbimit te nevojave shtepiace dhe si pronar i nje banese; **5.8.3** Si pronar dhe perdorues i nje bicikle te pa motorr; **5.8.4** Si nje ushtrues sporti, pervecse atyre qe lidhen me mjete motorrike ajrore, tokesore, ujore, sportive luftarake dhe gjahut; **5.8.5** Si pronar i mjeteve luftarake per mbrojtje dhe pjesmarrje ne gara te ndryshme: **a)** Ky sigurim mbulon per te njejtat shkaqe dhe ne te njejtën mase bashkeshortin dhe femijet e te Siguruarit, nese keto persona jetojne me te ne te njejtën bashkesi familjare dhe ne te njejtën shtepi; **b)** Pergjegjesia e punonjesit te sherbimit te nevojave shtepiace (sherbysesit) mbulohet vetem per shkak dhe ne masen qe lidhet me detyren e tij profesionale. **5.9** Ky sigurim mbulon pergjegjesine e **Shkolles, Institucioneve Edukative dhe Institute te Ngjashme**: **5.9.1** Te Anetareve te Bordit te Drejtimit, Mesuesve, Punonjesve dhe Punetoreve pergjate kryerjes se detyrave te

tyre funksionale; **5.9.2** Per shkak te humbjeve e demeve ne garderobat e nxenesve, pervec parave, sendeve me vlere, sahateve te dores, pajisjeve teknike dhe elektronike si kamera, video-kamera, Lap Top (portable computer) dhe pajisje te tjera ngjashme, kambiale e letra me vlere, dokumente te cdo lloji. Nese sendet humbin apo zhduken i Siguruari duhet te njoftoje menjehere Autoritetin kopetent (Policine e Shtetit); **5.9.3** Si dhe pergjegjesi qe vijne si rezultat i udhetimeve, ekskursioneve, aktiviteteve shkollore etj. **5.10** Ky sigurim mbulon gjithashtu edhe pergjegjesine e **Organizuesve te Aktiviteteve Sportive** me Bicikleta, motorrçikleta dhe gara makinash, por vetem nese Autoriteti Shteteror jep lejen per realizimin e aktiviteti dhe njekohesisht mbyll trafikun per mjetet e tjera; **5.11** Ky sigurim mbulon gjithashtu pergjegjesine e te Siguruarit te specializuar per montimin dhe çmontimin e pajisjeve te argetimit ose defrimit, si skena, artopolante etj. te kesaj natyre, per deme te ndodhura pergjate kryerjes se ketij sherbimi.

C. PJESA E PERG JITHSHME

Neni 6. "PERSHKRIMI I RRISKUT OSE AKTIVITETIT QE SIGUROHET (OBJEKTI I SIGURIMIT)"

6.1 Ne momentin e lidhjes se kontrates se sigurimit i Siguruari duhet te njoftoje Siguruesin me te gjitha rrethanat e rendesishme per vleresimin e riskut dhe per te cilat ai ka ose duhet te kishte dijeni. Rrethana qe konsiderohen te rendesishme ne vleresimin e rriskut, jane vecanerisht ato per te cilat i Siguruari eshte ose duhet te kishte dijeni ne baze te te cilave percaktohet ose perllogaritet primi i sigurimit, si dhe ato te shpallura ne kontraten e sigurimit (rubrikat e saj). Keto rrethana mund te percaktohen se bashku prej Policmbajtesit dhe Siguruesit.

Neni 7. "PËRLLOGARITJA DHE AXHUSTIMI I PRIMIT TE SIGURIMIT. PASOJAT E MOSPAGIMIT TE TIJ DHE KTHIMI I PRIMIT TË SIGURIMIT"

7.1 Përlllogaritja e primit të sigurimit bëhet sipas metodave të tarifimit të përcaktuara nga Siguruesi, si edhe në funksion të informacionit dhe të dhënave të deklaruar nga i Siguruari; **7.2** Në rastin kur përlllogaritja e primit bazohet mbi vlerën e qarkullimit monetar të veprimtarisë së të Siguarit për një periudhë të caktuar kohe, ky prim i nënshtrohet axhustimit. Primi i Sigurimit axhustohet jo më vonë se 30 ditë nga data e përfundimit të periudhës së sigurimit në varësi të ndryshimit të vlerës së qarkullimit monetar të të Siguarit, nëse nuk parashikohet ndryshe në policë. Diferencat aktive dhe pasive të axhustimit të primit duhet të kryhen nga palët brenda 15 ditëve nga përcaktimi i kesaj vlere; **7.3** Primi i sigurimit paguhet njëherësh ose me këste; **7.4** Përgjegjësia e Siguruesit të paguajë demshperblim për humbjen ose demin perfundon në rastin e mospagimit të primit të sigurimit, kështu të pare ose të radhes brenda afatit prej 15 ditësh duke filluar nga data e maturimit të pagesës së tij shënuar në policën e sigurimit, afat i cili skadon në orën 24.00 të ditës së 15-të. Vertetimi i faktit të mospageses si parashikuar këtu zgjidh automatikisht Kontratën e Sigurimit, pa patur nevojë për njoftim tjetër të veçantë nga Siguruesi; **7.5** I Siguruari është përgjegjës për pagesën e primit, kështu dhe/ose diferencës aktive të tij edhe në ato raste kur ai pretendon, që Siguruesi nuk e ka njoftuar për datat e maturimit; **7.6** Në rast të ndërprerjes së njëanshme të Kontratës së Sigurimit nga palët, primi i paguar i kthehet të Siguarit në perpjestim me kohën që mbetet deri në mbarim të afatit ose periudhës së mbulimit të kontratës së sigurimit, duke zbritur shpenzimet administrative përkatëse. Kthimi i primit ndalohet në këto raste: **7.6.1** Kur i

Siguruari ka përfituar ose do të përfitojë cdo demshperblim nga Siguruesi, pavaresisht vlerës së tij; **7.6.2** Kur primi i pafituar është jo më shumë se 10% e primit të shkruar.

Neni 8. "LIMITI I DEMSHPERBLIMIT PËR ÇDO NJE NGJARJE, LIMITI AGREGAT"

8.1 Limiti i demshperblimit për çdo një ngjarje sigurimi perbehet nga vlera monetare e të gjitha kërkesave për demshperblim që perfshihen ose që rrjedhin prej çdo një aksidenti ose serie aksidentesh të ndodhura në lidhje ose që rezultojnë nga ngjarje sigurimi, ose që kanë një shkak fillestar, pavaresisht momentit kur demi është bërë i dukshëm ose i është raportuar Siguruesit; **8.2** Limiti agregat ose i përgjithshëm i demshperblimit perbehet nga vlera monetare e të gjitha kërkesave për demshperblim të shkaktuara ose që rrjedhin nga të gjitha ngjarjet e sigurimit të ndodhura ose vertetuara brenda periudhës së sigurimit të shënuar në policën e sigurimit; **8.3** Shumat ose vlerat limit ose kufi për çdo një ngjarje dhe limiti agregat i demshperblimit shënohen në policën e sigurimit.

Neni 9. "AFATET DHE TERRITORI I VLEFSHMËRISË SË KONTRATËS SË SIGURIMIT"

9.1 Afati i vlefshmërisë (mbulimit) të kontratës fillon në orën 24.00 të ditës së përcaktuar si datë e fillimit të policës së sigurimit dhe përfundon në orën 24.00 të datës së përfundimit të shënuar në policë. Në çdo rast afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate nuk fillon përpara kalimit në llogarinë e Siguruesit të primit ose kështu të parë të tij. Afati i vlefshmërisë (mbulimit) të kësaj kontrate është si rregull një vit përveç, kur në Policën e Sigurimit përcaktohet ndryshe; **9.2** Territori i vlefshmërisë së kësaj kontrate është territori i Republikës së Shqipërisë, nëse nuk është vendosur

ndryshe me shenimin perkates ne police.

Neni 10. "NGJARJA OSE RASTI I SIGURIMIT"

10.1 Ngjarja ose rasti i sigurimit konsiderohet te kete ndodhe ne momentin kur ngjarja qe sjell humbjen ose demin i cili mundeson qe kunder te Siguruarit te paraqitet nje kerkese per demshperblim te kete ndodhur; **10.2** Humbja ose demi jane te demshperblyeshem kur ndodhin brenda afatit ose periudhes se sigurimit te shenuar ne police; **10.3** Nese eshte rene dakord dhe pranuar nga palet, nje pjese e demit mbahet nga i Siguruari (pjesa e zbritshme/ose nje vlere limit) dhe Siguruesi do te paguaje vleren e çdo rasti sigurimi duke zbritur pjesen qe mbahet per llogari te te Siguruarit.

Neni 11. "DETYRIMET E PALEVE ME NDODHJEN E NJE RASTI SIGURIMI "

A. Detyrimet e te Siguruarit: **11.1** Të marrë të gjitha masat dhe të kryejë të gjitha veprimet e mundshme për minimizimin e pasojave të demit/ve te shkaktuara nga ngjarja aksidentale; **11.2** Të njoftojë menjëherë Siguruesin per ndodhjen e aksidentit (ngjarjes se papritur). Nese nje hetim per kundravajtje penale ose civile fillon ose ka shenja (indicie) qe do te filloje kunder te Siguruarit ose personave per te cilet ai (i Siguruari) eshte pergjegjes njofton menjehere Siguruesin pavaresisht se kishte njoftuar me pare per ndodhjen e te njejtit aksident; **11.3** Nese i Siguruari merr nje kerkese per demshperblim nga te tretet ose veprime lidhur me demet kane filluar kunder tij, i Siguruari duhet te njoftoje menjehere Siguruesin dhe ti paraqese atij te gjitha dokumentet qe lidhen me kerkesen/at per demshperblim; **11.4** Të lejojë dhe ti jape fuqi ligjore perfaqesimi Siguruesit apo juristit te caktuar prej tij qe te drejtoje veprimet ligjore qe lidhen me ngjarjen aksidentale e pasojat e saj. Nese i Siguruari nuk lejon Siguruesin te

drejtoje zgjidhjen e kerkeses/ave per demshperblim, Siguruesi nuk eshte pergjegjes te paguaje kostot ekstra te kerkeses per demshperblim, interesat apo shpenzimet ligjore e te tjera te lidhura me te; **11.5** Në pajtim me detyrimin e percaktuar ne paragrafin (4), me siper te mos refuzoje dhe per me teper te mos pranoje asnje kerkese per demshperblim te ardhur nga te tretet.

B. Detyrimet e Siguruesit: **11.1** Të kontrolloje kerkesat per demshperblim si lidhur me percaktimin e pergjegjesise ashtu edhe vleren e demit ose humbjes, si dhe te siguroje mbrojtjen e te Siguruarit nga kerkesat e pajustificuara ose te egzagjeruara nga te tretet; **11.2** T'i japë të Siguruarit rekomandimet e nevojshme në bazë të të gjitha inspektimeve, ekspertizave dhe veprimeve të nevojshme për mbrojtjen e interesit të tij. Nëse i Siguruari refuzon të pranojë rekomandimet e Siguruesit: **11.2.1** Siguruesi nuk ka detyrim të mëtejshëm për të mbrojtur interesat e tij; dhe **11.2.2** Përgjegjësia e Siguruesit për dëme, në lidhje me limitin e dëmshpërblimit, nuk do të tejkalojë ose do të kufizohet ne vlerën e dëmshpërblimit të parashikuar nga ai (Siguruesi); **11.3** Të japë miratimin ose refuzimin e argumentuar për kryerjen e shpenzimeve të lidhura me mbrojtjen dhe përfaqësimin në gjykatë të të Siguruarit brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për këtë nga i Siguruari; **11.4** Te kompensojë të Siguruarin në përputhje me këto kushte sigurimi jo më vonë se 30 ditë nga dorëzimi i vendimit të formës së prerë të Gjykatës për përgjegjësinë e të Siguruarit, minus pjesën e zbritshme të shenuar në policën e sigurimit.

Neni 12. "PASOJAT JURIDIKE TË "DIJENISË" DHE "NJOFTIMIT" PËR NGJARJEN E SIGURIMIT"

Nëse vërtetohet që, i Siguruari ose

Policmbajtesi njoftojne Siguruesin, për një "ngjarje" ose "kërkesë për dëmshpërblim" nga palët e treta, për të cilat janë në dijeni, që dëmtime të shëndetit dhe dëme në sende ndaj palëve të treta kanë filluar të shkaktohen ose janë shkaktuar përpara fillimit të periudhës së vlefshmërisë së policës, atëherë çdo vazhdim, ndryshim, perkeqesim ose përfundim i pasojave të dëmeve në shëndet dhe sende gjatë ose pas periudhës së vlefshmërisë së policës, do të quhen të "ditura ose të njohura" përpara fillimit të periudhës mbulimit të kësaj police dhe Siguruesi çlirohet nga detyrimi i kompensimit.

Neni 13. "SIGURIME TË TJERA"

13.1 Nëse në momentin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, ekziston një ose disa polica të tjera në fuqi për mbulimin e përgjegjësisë të Siguruarit për të tilla ngjarje, atëherë Siguruesi i kësaj kontrate çlirohet ose nuk do të jetë përgjegjës për mbulimin për humbje të dëmeve të çdo kërkesë për dëmshpërblim, përveç asaj vlere dëmi që tejkalon shumën me të madhe të dëmshpërblimit të pagueshem ndërsa policat e tjera në fuqi; **13.2** Në rastin kur vlera e dëmshpërblimit të përcaktuar në këtë police tejkalon vlerën me të lartë të dëmshpërblimit të përcaktuar ndërsa policat e tjera në fuqi, atëherë Siguruesi i kësaj police është përgjegjës për dëmshpërblimin e të Siguruarit për një shumë të barabartë me diferencën që rezulton nga vlera e dëmshpërblimit për një ngjarje sigurimi të përcaktuar në këtë police me vlerën e dëmshpërblimit me të lartë të vertetuar ndërsa policat e tjera të sigurimit, si parashikuar në paragrafin (1) më sipër.

Neni 14. "PJESA E ZBRITSHME, FRANSHIZA"

14.1 Në këtë kontratë sigurimi do të aplikohet Pjesë e zbritshme e shprehur në

përqindje dhe/ose Franshizë e shprehur në vlerë nominale mbi çdo një dëm ose seri dëmsh të ndodhura nga një rast ose ngjarje e vetme sigurimi. Pjesa e zbritshme dhe/ose Franshiza shënohen në policën e sigurimit; **14.2** Siguruesi nuk do të paguajë dëme që vlerësohen më pak se vlera e Franshizës së përcaktuar në policë. Në të gjitha rastet e tjera, ku vlera e dëmit kalon kalon vlerën e Franshizës aplikohet Pjesa e Zbritshme në %, mbi shumën e dëmshpërblimit të përlogaritur për t'ju paguar të Siguruarit ose Përfituesit.

Neni 15. "PËRFUNDIMI DHE ZGJIDHJA E KONTRATËS"

Kjo kontratë sigurimi: **15.1** Përfundon kur ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe Siguruesi ka dëmshpërblyer të Siguruarin në limitin agregat të përcaktuar në policën e sigurimit; **15.2** Zgjidhet menjëherë kur primi, kësti e tij dhe vlera e axhustimit nuk janë paguar brenda 15 ditëve nga afati i maturimit të pagesës; **15.3** Zgjidhet menjëherë kur Siguruesi njihet me të dhëna ose fakte të reja, që më parë janë fshehur ose deklaruar në mënyrë të rreme qëllimisht nga i Siguruari. **15.4** përfundon kur njëra nga palët shprehet në mënyrë të njëanshme për ndërprerjen e saj me njoftim paraprak 30 ditor. Ky njoftim do të quhet i kryer që në ditën e dërgesës së tij me postë.

Neni 16. "MENYRA E KOMUNIKIMIT, NDRYSHIMI I ADRESES"

16.1 Te gjitha njoftimet e shpalljet që duhet të paraqiten ose të jepen në pajtim me parashikimet e Kontrates së sigurimit behen me shkrim. **16.2** Njoftimet e shpalljet konsiderohen se janë kryer në kohë nëse dërgohen me leter të rregjistruar brenda afatit të parashikuar. **16.3** I siguruari duhet të njoftojë Siguruesin për ndryshimin e emrit apo adresën e selisë së kompanisë. Nëse i



Siguruari ndryshon emrin apo adresen e kompanise dhe nuk njofton Siguruesin, eshte e mjaftueshme qe Siguruesi te dergoje njoftimet ne emrin dhe adresen e rezidences se fundit te tij.

Neni 17. "LIGJI I APLIKUESHEM, ZGJIDHJET E MOSMARRËVESHJEVE"

17.1 Ligji i aplikueshem ne marredheniet ndermjet Siguruesit dhe te Siguruarit, kur nuk zgjidhen nga percaktimet e ketyre kushteve e termave te kesaj kontrate sigurimi, eshte Kodit Civil i Republikes se Shqiperise, percaktimet dhe parashikimet e Pjeses se IV-tert - Detyrimet dhe Kreu XXIII - Sigurimet.

17.2 Në rastet kur mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet palëve, kompetente është gjykata e vendit ku është lëshuar polica e sigurimit.

Shojca LMA5393, dt. 25.03.2020: "Per Semundjet e Shpalluara" aplikohet ne te gjithë mbulimet, shtojcat, mbulimet shtese, perjashtimet e çdo perjashtimi, dhe çdo mbulimi te dhene tjeter ne kete police.

